



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETKES**  
*Drejtoria e Administrimit te Prones Publike*

**URDHER**

Nr. 776 Date 01.11.96


**PER KRIJIMIN E SHOQERISE SH.A "NPV" DURRES DHE  
ÇREGJISTRIMIN E SH.A. "NPV NR. 3" DURRËS DHE  
SH.A. "NPV NR.4" DURRËS**

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996 dhe Ligjin Nr. 8158, date 07.11.1996 dhe nenet 128, 254 te ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", me cilësinë e aksionerit të vetëm ,

**URDHEROJ :**

1. Krijimin e shoqërisë Sh.A. "NPV" Durrës me kapital te nënshkruar 74,500,000 leke, i përbëre nga 74,500 aksione me vlerë nominale 1000 leke secili.
2. Te çregjistrohen shoqëritë Sh.A. "NPV Nr. 3" Durrës dhe Sh.A. "NPV Nr.4" Durrës.
3. Këshilli Mbikqyres i shoqërisë Sh.A. "NPV" Durrës përbehet nga:
  - Suzana Stefa
  - Jeta Abazi
  - Rajmonda Boksi
4. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Juridike per zbatimin e ketij urdhri.  
Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

MINISTER



Adresa: Blvd."Deshmoret e Kombit" Nr.2  
E-mail: [smalko@mete.gov.al](mailto:smalko@mete.gov.al)